



Prishtinë, 27 nëntor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1203_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 7 nënparagrafet 7.2, Nenit 16 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, Nenit 26 dhe Nenin 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Vendimin e Rregullatorit V_1107_2019 për Miratimin Përfundimtar të Certifikimit të KOSTT SH.A si Operator i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike;
- Opinionin 02/19, e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Certifikimin e KOSTT/OST, të datës 01.02.2019, të nxjerrë në pajtim me Nenin 3 (1) të Rregullores (EC) Nr. 714/2009 dhe Nenin 10 (6) të Direktivës 2009/72/EC,
- Nenin 1, paragrafin 4, nënparagrafin 4.2 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017);
- Kërkesën e KOSTT për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë nga Rregullatori, të datës 18.11.2019.

Në seancën e mbajtur me datë 27 nëntor 2019, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) të KOSTT SH.A.**

Arsyetim

- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 15 shkurt 2019 ka nxjerr vendimin V_1107_2019 për Miratimin Përfundimtar të Certifikimit të KOSTT, në të cilin përveç tjerash ka kërkuar nga KOSTT të hartoj dhe të dërgoj në Zyrën e Rregullatorit për Energji (në vijim "Rregullatori") Programin e Pajtueshmërisë së KOSTT/OST, për miratim.
- o KOSTT ka hartuar Programin e Pajtueshmërisë dhe ka dërguar në Rregullator për komente me datë 15 gusht 2019.



- Pas komentimit të palëve, KOSTT me datë 18.11.2019 ka dërguar në Rregullator Programin e Pajtueshmërisë dhe ka kërkuar që i njëjti të aprovohet nga Bordi i Rregullatorit.
- Rregullatori ka shqyrtuar kërkesën e KOSTT për miratim të Programit të Pajtueshmërisë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- Procedurat për ndryshim/plotësim të Programit të Pajtueshmërisë do të jenë të njëjta si për miratim të tij.
- Zyrtari i Pajtueshmërisë, po ashtu i aprovuar nga Rregullatori me datë 14 tetor 2019 (Vendimi V_1186_2019), duhet të raportoj në Rregullator në pajtim me Programin e Pajtueshmërisë së KOSTT dhe dispozitat tjera të legjislacionit në fuqi.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bashkëngjitur këtij vendimi është ***"Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) të KOSTT-it ("Programi i Pajtueshmërisë")"***.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT SH.A dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, U.D. kryesues


Besim Bejri, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar